KËRKESË
Nr. 56, datë 8.1.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Eliminimi i pikave të zeza (*Black Spots*) në rrjetin rrugor kombëtar Shkodër–Hani i Hotit, kryqëzimi rruga e Hurmave", me vlerë totale paraprake të shpronësimin 44,010 (dyzet e katër mijë e dhjetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasurinë e llojit "arë", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 44, 010 (dyzet e katër mijë e dhjetë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ELIMINIMI I PIKAVE TË ZEZA (*BLACK SPOTS*) NË RRJETIN RRUGOR KOMBËTAR SHKODËR–HANI I HOTIT, KRYQËZIMI RRUGA E HURMAVE"

Nr.	Pronari										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
											"Arë"			"Truall"				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m^2)	"Truall" (m^2)	"Ndërtesë" (m^2)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Vlera Totale (lekë)	
1	Shuaip	Smail	Haxhia	3428	29/1	arë	8000				128	270	34560				34560	
2	Smail	Ali	Haxhia	3429	101/16	arë	8175				35	270	9450				9450	
	SHUMA PARAPRAKE																**44010**	